



**VENDIM**

**Nr. 1 Datë 17.01.2014**

**PËR  
FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENSIMIT TË  
SHOQËRISË “AYEN ENERGY TRADING” SH.A NË  
AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TE KUALIFIKUAR TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8 pika 2, gërma “a”; 9 dhe nenit 45 pika “4” dhe 48 pika 2, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “f”; 5 pika 1 gërma “f” 8; 10, pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të “Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve, Nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 17.01.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “AYEN ENERGY TRADING” sh.a, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

**Konstatohet se :**

Aplikimi i shoqërisë “AYEN ENERGY TRADING” sh.a plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni finaciari dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 gërmat “a”, “b”, “c”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për liçensë të shoqërisë “AYEN ENERGY TRADING” sh.a në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.